

- A ka nisur “kompania Eni Albania” B.V punën në bllokun e Dumresë në dijeni të institucionit tuaj? Në çfarë date dhe në çfarë faze është puna?

Me hyrjen ne fuqi te Marreveshjes me Ndarje Prodhimi ne Mars te vitit 2020 kompania Eni Albania B.V ka nisur aktivitetin dhe punen per permbushjen e Programit Minimal te Punes per Periudhen e Kerkimit. Aktualisht kompania ka perfunduar me fushaten sizmike ne kete bllok dhe po kryen projektimin e pusit qe do te shpohet ne vitin 2024.

-A ka dorëzuar kompania një VNM? Nëse po në çfarë date?

Persa i perket informacioneve mbi VNM ju lutem drejtohuni Agjencive perkatese mjedisore sipas legjislacionit ne fuqi.

-Kopje të VNM që kompania Eni ka dorëzuar.

Ju lutem referohuni pergjigjes se mesiperme.

-Në dijeni të institucionit tuaj a ka burime dhe monumente natyrore qe rrezikohen nga aktiviteti që do të kryejë kompania Eni në bllokun e Dumresë? Cilat janë këto monumente? Çfarë masash ka marrë institucioni juaj në lidhje me këtë çështje?

Lidhur me informacionet mbi burimet dhe monumentet e kultures ju lutem drejtohuni prane institucioneve perkatese per monitorimin dhe ruajtjen e tyre sipas legjislacionit.

-A ka kryer kompania në fjalë konsultim publik me banorët e fshatrave të cilat do të preken nga ky aktivitet. Kur është kryer konsultimi ?Një kopje të raportit(dosje edhe dëgjesa me publikun sipas legjislacioneve në fuqi) nëse institucioni juaj e disponon.

Kompania Eni Albania B.V ka zhvilluar disa degjesa publike si dhe takime me palet e interesit lidhur me aktivitetin qe po kryen ne kete bllok. Lidhur me raportet e ketyre takimeve ne dijenine tone jane bere pjese e dosjes se depozituar per miratimin e VNM-se. AKBN ne kuader te parashikimit te nenit te konfidencialitetit te kesaj marreveshje lidhur me keto raporte duke qene se keto jane dokumentacion i hartuar prej Kompanise Eni, do te kerkoj paraprakisht miratimin e Kompanise lidhur me dhenien e tyre.

-Çfarë licencash dhe lejesh zotëron kompania “ENI Albania” për ushtrimin e aktivitetit në fjalë? Kopje të listës nëse instiucioni juaj e zotëron.

AKBN ndjek zbatimin e marreveshjes hidrokarbure lidhur me kryerjen e operacioneve hidrokarbure nga ana Kompanise. Lidhur me lejet dhe licensat e mundshme, eshte obligim i Kompanise marrja e tyre sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi si dhe ndjekja e institucioneve te tjera lidhur me pajisjen ose jo te Kompanise me lejet apo licensat perkatese.

- Kontrata krijon gjithashtu një fond trainimi dhe administrimi prej 600,000 USD në vit për të përfituar punonjës të AKBN-së, studentë dhe punonjës të tjerë të qeverisë dhe për të rritur njohuritë teknike të Shqipërisë. A e ka paguar kompania këtë detyrim? A kanë përfituar punonjës të AKBN-së, studentë dhe punonjës të tjerë të qeverisë nga ky fond? Nëse po a mund të kemi një dokument që e vërteton? Nëse jo pse kompania nuk e ka paguar fondin në fjalë?

Kompania ka permbushur te gjitha detyrimet kontraktuale qe lidhen me bonusin e trajnimit dhe administrativ sipas KNP. Punonjes te AKBN-se kane perfituar nga keto trajnime dhe specializime ne kuader te ketij neni duke u pajisur me certifikata personale pas perfundimit te ketyre trajnimeve.